

**23.02.2022
Ora 16:37**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e Kodit të Etikës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- | | | |
|------------|-------|------------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | Y.Merkaj, M.Koja |

Parti Politike: S’ka

OJQ: KRIK

Znj. I. Nano: Përshëndetje! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të thirrur për ditën e sotme, datë 23 shkurt. Njoftimi për mbledhjen është publikuar në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, gjithashtu u është drejtuar dhe përfaqësuesve të partive politike dhe subjekteve zgjedhore nëpërmjet e-mail-it. Në rendin e ditës së mbledhjes së sotme kemi shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e Kodit të Etikës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”. Paraprakisht më lejoni të pyes kolegët nëse kanë ndonjë çështje jashtë rendit të ditës, për të cilën duan të diskutojnë, kolegë? Para se të fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit duhet thënë që të pranishëm në mbledhje përveç anëtarëve të

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.23.02.2022*

Komisionit Rregullator, janë edhe Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe zyrtarë të tjerë të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kodi i Etikës që ka ardhur sot për shqyrtim në Komisionin Rregullator është propozuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Do t'i lutesha zotit Merkaj, Sekretarit të Përgjithshëm, në mënyrë të përmbledhur të paraqiste projektaktin, zoti Merkaj!

Z. Y. Merkaj: Në mbështetje të nenit 12, pika 4 dhe nenit 20, pika 1, shkronja "a", të Kodit Zgjedhor, si dhe rezolutës së Kuvendit për vlerësimin e veprimitarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2020, kemi përgatitur projektvendimin "Për miratimin e Kodit të Etikës". Kodi i Etikës ka për qëllim t'u ofrojë organeve drejtuese, Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve një set vlerash dhe parimesh që sjell pasojë sjellja e tyre. Kodi trajton në mënyrë të përshtatshme, përgjegjësitë në promovimin dhe mbrojtjen e vlerave etike në çdo aspekt të organizimit të aktiviteteve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kodi përfshin një qasje të përgjithshme ndaj sjelljes etike, një përshkrim të përgjithshëm të rregullave që duhet të ndiqen nga organet drejtuese, Nënkomisioneri dhe administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kodi i Etikës përbëhet nga 4 krerë dhe 16 nene. Kreu i parë trajton qëllimin, fushën e veprimit dhe parimet e përgjithshme. Kodi i Etikës ka për qëllim të garantojë etikë, sjellje të mirë e seriozitet në ushtrimin e detyrave publike për të rritur besueshmërinë e publikut ndaj zyrtarëve të përfshirë në proceset zgjedhore. Neni 2 është fusha e veprimit. Dispozitat e këtij Kodi janë të detyrueshme për organet drejtuese, duke filluar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpunësit civilë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe ata të punësuar me kohëzgjatje të pacaktuar sipas Kodit të Punës, punonjës të punësuar në kabinetin

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.23.02.2022*

e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, punonjës të punësuar me kohëzgjatje të caktuar në periudhë zgjedhore, administrata zgjedhore e niveleve të tjera, të dyta dhe të treta, si dhe praktikantë që ushtrojnë praktikë pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Gjithashtu ka trajtuar dhe parime të përgjithshme, siç janë parimi i ligjshmërisë, objektiviteti, paanshmëria, ndershmëria dhe pavarësia, përgjegjshmëria, parimi i mosdiskriminimit, transparenca, parimi i konfidencialitetit dhe konfliktit të interesit. Kreu 2 trajton rregullat e etikës për anëtarët e organeve drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kryerjen e e detyrave, si dhe detyrimet që kanë për të ndjekur dhe zbatuar këto rregulla. Kreu 3 trajton rregullat e etikës për zyrtarët e administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kryerjen e detyrave të tyre. Zyrtari i Komisionit të KQZ-së duhet të jetë i paanshëm, i besueshëm, transparent, efektiv duke realizuar me disiplinë dhe në kohë detyrat funksionale në respektimin e interesit publik. Gjithashtu trajton paraqitjen në punë, mirësinë dhe respektin e stafit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përdorimin e kohës së punës, përdorimin e pronave, burimeve e pajisjeve të KQZ-së, konfliktin e interesit, si dhe dhuratat dhe favoret. Gjithashtu, në këtë kre trajtohen dhe detyrimet e zyrtarit pas periudhës së punësimit, i cili ndalohej të përdorë informacionet konfidenciale pasi është larguar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Kreu 4 ka dispozitat përfundimtare, ku është përcaktuar zbatimi i Kodit dhe njësia përgjegjëse, e cila u bën me dije zyrtarëve ose punonjësve në çastet e fillimit të detyrës, detyrimet që rrjedhin nga ky Kod. Kodi është hartuar duke iu referuar dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, duke iu referuar organizatës IDEA, i cili është Instituti për Demokraci dhe Asistencë Zgjedhore. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Merkaj! Sikundër ju e theksuat në prezantimin e aktit përveç të tjerash nxitje për hartimin e projektvendimit “Për miratimin e

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.23.02.2022*

Kodit të Etikës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, është dhe rezoluta e Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2020, ku në mënyrë eksplicite është kërkuar hartimi dhe miratimi i një Kodi Etike për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Çelim diskutimin në parim. Kolegë? Nëse nuk ka diçka lidhur me diskutimin në parim, kalojmë në votimin në parim të projektvendimit “Për miratimin e Kodit të Etikës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro, miratohet në parim!

Fillojmë me shqyrtimin nen për nen.

Neni i parë. Komisioni Rregullator vendosi: Miratimin e Kodit të Etikës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi. Atëherë për të shqyrtuar nenin 1 do të duhet të shohim tekstin e projektit, pra të projektkodit të Etikës. E nisim me preambulën. Kemi diçka lidhur me preambulën? Kalojmë tek kreu 1. Qëllimi dhe parime të përgjithshme. Neni 1. Qëllimi. Kolegë, nëse ka pyetje për administratën apo propozime për shtesa, ndryshime, qoftë edhe saktësime apo sqarime të nevojshme? Nëse nuk ka, kalojmë në votimin e nenit 1. Qëllimi.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 2. Fusha e veprimit. Sikundër u theksua dhe në prezantimin e projektaktit dispozitat e këtij kodi, janë të detyrueshme për organet drejtuese dhe për zyrtarët apo punonjësit e KQZ-së, sipas të gjitha kategorive, duke nisur nga Komisioneri, Komisioni Rregullator, KAS-i, Nënkomisioneri, nëpunësit civilë të KQZ-së, ata

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.23.02.2022*

të punësuar me kohëzgjatje të pacaktuar sipas Kodit të Punës, punonjësit e kabinetit, punonjësit e punësuar me kohëzgjatje të caktuar gjatë periudhave zgjedhore, administrata zgjedhore e niveleve të tjera në periudhë zgjedhore dhe praktikantët që mund të ushtrojnë praktikën pranë KQZ-së. Kemi diçka për nenin 2, ju lutem? Zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Në sinkron dhe unifikim me zyrtarët e zgjedhur apo nëpunësit e emëruar, apo ata të punësuar përkohësisht, patëm parasysh gjatë lëçitjes së këtij drafti, ndarjen në dy kategori të punonjësve. Në zyrtarë të emëruar dhe njëkohësisht në punonjës, apo zyrtarë të përhershëm dhe të përkohshëm. Në funksion të saktësimit të kësaj logjike që përmenda, në pikën 1 do të sugjeroja, sepse konsideroj që është një harresë e draftuesve, që pas organeve drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të shtohet edhe Nënkomisioneri, pasi është pjesë e zyrtarëve të emëruar.

Znj. I. Nano: Parimisht edhe unë jam dakord me këtë vërejtje të zonjës Vukaj, që dhe unë mendoj që ka qenë një lloj harrese gjatë zbardhjes, sepse më tej ne e gjejmë Nënkomisionerin, apo dhe në nenet e tjera. Kështu që dëshironi që këtë propozim ta kalojmë për votim apo ta konsiderojmë një saktësim që administrata gjatë zbardhjes, pas miratimit të këtij vendimi, pas “organeve drejtuese”, të shtojë dhe fjalën “Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve” dhe më tej të kalojmë tek “zyrtarët/punonjësit”. Pjesa tjetër nga “a” tek “i” besoj se janë listuar korrekt të gjitha kategoritë e zyrtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, qoftë ata që janë me kohë të plotë, kohë të pjesshme, të punësuar vetëm në periudhë zgjedhore apo jo? Nëse ka diçka nga administrata për të saktësuar? Jo! Atëherë, besoj me mirëkuptimin e të gjithë anëtarëve, këtë po e konsiderojmë një saktësim që duhet bërë gjatë zbardhjes. Atëherë kalojmë në votimin e nenit 2, ju lutem.

Kush është dakord?

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.23.02.2022*

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 3. Parime të përgjithshme. Kemi diçka lidhur me nenin 3? Me parime të cilat janë dhe vlejné për gjithë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, pavarësisht nga kategoritë që u përmendën në nenin 2, fusha e zbatimit. Nëse nuk ka diçka kalojmë në votimin e nenit 3?

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kalojmë në kreun 2. Rregullat e etikës për anëtarët e organeve drejtuese dhe Nënkomisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve. Neni 4. Kryerja e detyrave me ndershmëri, paanshmëri, efikasitet. Kemi diçka? Po zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Përsëri në sinkron dhe në unifikim të dy kategorive që kemi parasysh, për saktësi, ose nëse e konsideroni propozim, është zgjedhja juaj, do sugjeroja ose saktësoj se kreu 2 duhet të ketë një vijueshmëri të së njëjtës logjikë, dhe duhet të ishte "rregullat e etikës për organet drejtuese dhe Nënkomisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve", pasi e dimë që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve është organ drejtues, por nuk është anëtar, dhe në momentin kur këtu draftimi përmend vetëm anëtarët e organeve drejtuese, konsiderohet si një përjashtim nën zë, apo një mungesë përfshirjeje. Kështu që unë sugjeroj të jetë "Rregullat e etikës për organet drejtuese dhe Nënkomisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve", dhe kjo logjikë të ndjekë në vijimësi të gjitha pikat e nenit 4. Ose nëse administrata ka nevojë që të ndalemi në të gjitha pikat për saktësi, mund ta bëjmë, që të jetë më e lehtë zbardhja, ose si të doni.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.23.02.2022*

Znj. I. Nano: Duke iu bashkuar shqetësimit që ngriti zonja Vukaj sa i përket titullit të kreut, jam plotësisht dakord me riformulimin “Rregullat e etikës për organet drejtuese dhe Nënkomisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve”. Më tej në tekst mendoj që duhet nominalisht që të përmendej Komisioneri dhe anëtarët, sepse detyrimet lidhen me mosmarrjen pjesë në shqyrtimin dhe vendimmarrjen kur ka interes personal, që do të thotë është detyrim personal, qoftë i Komisionerit, qoftë i anëtarëve të Rregullatorit dhe KAS-it. Pra, mendoj, propozoj, ose le të diskutojmë. Në pikën 1, po e formuloj “Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, anëtarët e organeve të tjera drejtuese të KQZ dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të marrin pjesë në shqyrtimin dhe vendimmarrjen për një çështje nëse ka interes personal ndaj saj”. Më tej në tekstin e të gjithë vendimit, në rastet kur bëhet fjalë për detyrimet personale të secilit anëtar të organeve drejtuese, do të duhet të shtojmë dhe Komisionerin, ose mund t’i shohim rast mbas rasti. Pra, duhet parë nen për nen dhe germë për germë nëse ka, të reflektohet kjo gjë. Atëherë hedhim në votim propozimin e zonjës Vukaj për ndryshimin e titullit të Kreut 2 “Rregullat e etikës për organet drejtuese dhe Nënkomisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve”.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kalojmë tek propozimi për pikën 1 dhe pastaj nëse e miratojmë do të duhet të reflektohet rast mbas rasti. Atëherë pika 1 riformulohet si më poshtë “Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, anëtarët e organeve të tjera drejtuese të KQZ-së, dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të marrin pjesë në shqyrtimin dhe vendimmarrjen për një çështje nëse ka interes personal ndaj saj”.

Kush është dakord?

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.23.02.2022

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet edhe ky propozim!

Atëherë kalojmë në votimin në tërësi të nenit 4.

Me reflektimet që sapo miratuam, kush është dakord ?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet neni 4!

Neni 5. Shfaqja e mendimit të konfidencialitetit dhe solidarësisë. Zonja Vukaj, po!

Znj. H. Vukaj: Një sqarim ose saktësim. Përsëri dhe në nenin 5 konsideroj se duke reflektuar propozimet apo saktësimet e bëra deri tani, pasi secili nga organet drejtuese prodhon akt dhe përsa kohë akti shprehet përmes vendimmarrjes, mendoj që në të dyja pikat, si në pikën 1, si në pikën 2, ose do shtohet fjala “Komisioneri” ose do përmendim “Organet drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, dhe Nënkomisioneri, të shtohet Nënkomisioneri, “përveç organeve drejtuese dhe Nënkomisioneri”, për rastet kur ai ka të drejtë vendimmarrjeje, në bashkërendim me Komisionerin.

Znj. I. Nano: Administrata ka diçka lidhur me nenin 5? Pra, do të reflektojmë atë që votuam në nenin 4. Mirë atëherë kalojmë në votimin e nenit 5.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kalojmë në Kreun 3. Rregullat e etikës për zyrtarët e administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Pra, pasi kemi bërë ndarjen në kategori dhe në një kre të

Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.23.02.2022*

veçantë, janë detyrat e funksionarëve të zgjedhur nga Kuvendi ku përfshihen Komisioneri, anëtarët e organeve të tjera drejtuese dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Vijnë në kreun e posaçëm për zyrtarët e administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Neni 6. Kryerja e detyrave me ndershmëri, paanshëmri, efikasitet. Zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Në kre konstatoj që në funksion të nenit 2, ku ne shtuam “zyrtarët/punonjësit” të shtohet pas fjalëve “zyrtarët/punonjësit” për të gjithë kategorinë, e cila punësohet me kohë të pjesshme, ose provizorisht.

Znj. I. Nano: Për titullin e kreut?

Znj. H. Vukaj: Për titullin e kreut!

Znj. I. Nano: Në rregull! Në fakt jo në secilin nen është e përshtatshme fjala “zyrtarët/punonjësit” sepse në pikën “d” besoj që flisni për parimin e deburokratizimit të efincës që ka të bëjë me zyrtarët që janë të përfshirë në vendimmarrje. Pra, në shkronjën “a” është “zyrtari, punonjësit”, në shkronjën “b” “zyrtari, punonjësi”, në shkronjën “c” është “zyrtari”, duke patur parasysh realizimin në kohë të detyrave funksionale. Kështu që edhe këtu besoj që mund të shtohet, në pikën “c”, në pikën “ç” është, ndërsa në pikën “d” mendoj që lidhet kryesisht me zyrtarët që janë pjesë e vendimmarrjeve, duke patur parasysh ndarjen që bëjnë në zyrtarë dhe punonjës. Atëherë votojmë propozimin e zonjës Vukaj për të shtuar “punonjësit” në titullin e kreut.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro, miratohet!

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



Dhe kjo pastaj të reflektohet dhe në pikën "c".

Kalojmë në votimin e nenit 6.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 7. Paraqitja në punë. Mirësjellja dhe respekti. Ndoshta dhe këtu tek pika 1 "zyrtari/punonjësi". Nëse nuk kemi diçka për nenin 7, kalojmë në votimin e nenit 7.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 8. Zgjidhja e problemeve dhe e konflikteve personale. Nuk ka pyetje apo propozime. Kalojmë në votimin e nenit 8.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 9. Përdorimi i kohës së punës.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 10. Përdorimi i pronave, i pajisjeve dhe i burimeve të KQZ-së. Duke përfshirë këtu pronën publike, qoftë asetet në pronësi apo në administrim të KQZ-së, po qoftë dhe dokumentacionin zyrtar dhe detyrimin e zyrtarëve, punonjësve për ta menaxhuar me kujdes dhe duke mos lejuar që prona publike dhe

dokumentacioni zyrtar të përdoret për qëllime të tjera, përveçse për realizimin e detyrave.

Kush është dakord kolegë, me nenin 10?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 11. Qasja në informacion dhe konfidencialiteti. Kemi ndonjë vërejtje, ndonjë shqetësim, pyetje? Jo! Kalojmë në votimin e nenit 11.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 12. Konflikti i interesave. Sigurisht që ka një ligj të posaçëm për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve zyrtare, por çështja e konfliktit të interesave duke qenë aq e mprehtë, është pjesë e detyrimeve të parashikuara qoftë në kodet e etikës të institucioneve, qoftë në rregulloret e brendshme. Kështu që një nen, ndoshta jo shumë i detajuar, unë mendoj që është i domosdoshëm gjithmonë duke iu referuar pastaj zgjidhjeve që ofron legjislacioni në fuqi, për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave.

Kush është dakord me nenin 12, ju lutem?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 13. Veprimtaritë e jashtme. Ky nen parashikon si veprimtaritë e lejuara dhe ato të ndaluara dhe detyrimin kur zyrtari i KQZ-së të marrë miratimin e titullarit për disa veprimtari, si ajo mësimdhënëse apo trajnuese.

Kush është dakord me nenin 13?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



Kundra: *S'ka*

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 14. Dhuratat dhe favoret. Edhe në këtë nen parashikohen detyrimet e punonjësit për të mos kërkuar, për të mos pranuar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë. Disa kategori të specifikuara në pikën 1, në germat a, b dhe c, që përbëjnë konceptin e dhuratës apo të favorit, përfshirë premtime, përfitime, ftesa për pritje të ndryshme, përfitime të bursave të studimit dhe të sigurimeve e me radhë. Ajo çka është më e rëndësishme, specifikimi i faktit që edhe në rastin e dhuratave të lejuara, në asnjë mënyrë ato nuk duhet të jenë në vlerë monetare. Kolegë votojmë nenin 14, ju lutem.

Kush është dakord?

Pro: *5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)*

Kundra: *S'ka*

Me 5 vota pro, miratohet!

Neni 15. Detyrimet e zyrtarit pas periudhës së punësimit. Sikundër dhe zoti Merkaj në prezantimin e aktit e thia detyrimin, qoftë për mospërdormin e informacionit kofidencial të marrë për shkak të detyrës, për përdorimin për interes personal, dhe këtu nuk ka asnjë afat, qoftë detyrimin për një periudh dy vjeçare, pas largimit nga detyra për cilindo shkak, detyrimin për të mos përfaqësuar asnjë person apo organizatë në konflikt, apo marrëdhënie tregtare me KQZ-në. Kolegë, kemi diçka për nenin 15? Nëse jo kalojmë në votimin e nenit 15.

Kush është dakord?

Pro: *5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)*

Kundra: *S'ka*

Me 5 vota pro, miratohet!

Znj. I. Nano: Kreu 4. Dispozita përfundimtare. Neni 16. Zbatimi i Kodit. Kemi diçka lidhur me nenin 16? Zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: E shoh në dilemë pikën 2 të nenit 16, të këtij draftkodi për sa kohë ngarkon anëtarët e organeve drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Nënkomisionerin. Për shkak se vetë kodi na obligon që detyrim i vendimmarrjes tonë të jetë Kodi Zgjedhor, aktet e tjera nënligjore dhe Ligji “Për konfliktin e interesave”. Kjo pikë, ose për hir të draftimit dhe teknikës, qasjes së një kodi si dhe kodet e tjera me persona të ngarkuar për zbatim mund të ishte... dmth të mos ishte në mënyrë të drejtë për drejtë fjala “ngarkohen anëtarët e organeve drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, por të ishte përgjithësuese. Ku anëtarët të zëvendësoheshin thjesht me “organet drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Nënkomisioneri..”. Të vihej në funksion të.. të gjendej një zgjidhje tjetër. Ndoshta administrata mund të na sqarojë, ose të na japë një opinion tjetër se çfarë ka pasur parasysh me këtë lloj gjetje të pikës 2.

Z. Y. Merkaj: Këtu kemi pas parasysh..

Znj. I. Nano: Zoti Merkaj, një moment të japë një opinion zoti Çakaj!

Z. M. Çakaj: Ajo çfarë nuk qëndron nëse e kuptova drejt, në pikën 2 të nenit 16 të këtij kodi, kam përshtypjen është formulimi. Pra, formulimi qoftë ligjor, qoftë nga ana gramatikore. Nëse e kuptova drejt zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: E ke kuptuar shumë drejtë dhe të qasemi të bëjmë një formulim sa më të përshtatshëm.

Z. M. Çakaj: Unë do të propozoja një riformulim të tillë. “Për zbatimin e normave të këtij kodi, ngarkohen...” . ose, “Komisioneri Shtetror i Zgjedhjeve, anëtarët e organeve drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, zyrtarët/punonjësit e KQZ-së, janë të detyruar të zbatojnë normat e këtij kodi. Ky formulim nxjerr qartazi, besoj atë... Pra, ajo çfarë vret në formulimin e kësaj është “ngarkohet”. Duke qenë se normat e parashikuara në këtë kod janë për ne, nuk janë për të tretët. Pra, ne kemi detyrimin t’i zbatojmë këto norma, qoftë organet drejtuese, qoftë Komisioneri Shtetëror, qoftë zyrtarët apo punonjësit e përkohshëm. Në rastin konkret formulimi korrekt, ligjor dhe gramatikor do të ishte që këta personat të cilët kanë detyrimin të zbatojnë normat e këtij kodi, thjeshtë...

Znj. I. Nano: Cili do të ishte propozimi juaj zoti Çakaj? Unë jam shumë dakord që në çdo rast të shtohet Komisioneri, anëtarët e organeve të tjera drejtuese, por mënyra e formulimit si e mendoni?

Z. M. Çakaj: Propozimi im do të ishte: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, anëtarët e organeve drejtuese të KQZ-së, Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve si dhe zyrtarët/punonjësit e KQZ-së, janë të detyruar të zbatojnë parashikimet e këtij kodi.

Znj. I. Nano: Dakord, ky është një propozim. Më herët zonja Vukaj ju drejtua administratës. Kishit diçka zoti Merkaj, zonja Koja!

Znj. H. Vukaj: Thjesht gjithshka ishte në kuadër të diskutimit, le të themi të ridraftimit në një format më të pranueshëm dhe që i qëndron edhe parashikimeve të Kodit, por ka dhe tolerancën që le ta quajmë këtë Kod Etik si një akt nënligjor të dalë në funksion të gjithë sinkronizimit të detyrimeve që burojnë nga kodi.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



Kështu që zoti Çakaj në propozimin e tij ishte korrekt dhe afër asaj çfarë diskutova, por nga ana tjetër një optikë tjetër e të parit është për sa kohë ne normojmë aktin, mund të ishte një organ tjetër siç është organi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, që të ngarkohej me mbikqyrjen dhe zbatimin e këtij kodi. Një version tjetër! Përsëri këtë e diskutojmë dhe e mendojmë me qëllim draftimin sa më të konsoliduar të këtij neni.

Znj. I. Nano: Në fakt çështja e mbikqyrjes është diçka tjetër mendoj. Zbatimi lidhet me detyrimin që marrin përsipër secili nga ne për të zbatuar këto dispozita të këtij kodi. Kështu që do të duhet të ndajmë në këtë moment riformulimin sipas propozimit të zotit Çakaj, apo do të duhet të shtojmë edhe mbikqyrjen nga ana e Komisionerit.

Z. M. Çakaj: A e kemi në pikën 1 mbikqyrjen?

Znj. I. Nano: Njësia e personelit lidhet me bërjen të ditur me zyrtarët/punonjësit që në momentin e punësimit, të detyrimeve të këtij kodi...

Z. M. Çakaj: Po për mbikqyrjen?

Znj. H. Vukaj: Kush e mbikqyr?

Znj. I. Nano: Zonja Koja!

Znj. M. Koja: Sikundër edhe ligji për etikën përcakton, për administratën, për nëpunësin civil është eprori i çdo punonjësi i cili e mbikqyr respektimin e kodit të etikës. Nëse vëren raste të shkeljes, atëherë ai vijon pastaj me procedurat e tjera. Mbikqyrjen e bën eprori i drejtë për drejtë.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



Z. M. Çakaj: Pra, për zyrtarët dhe punonjësit e bën nëpunësi më i lartë ekzekutiv, ndërsa për kabinetin e tij e bën vetë Komisioneri, sipas rastit.

Znj. I. Nano: Në rast se do të bënim mbikqyrjen e kodit për secilën nga kategoritë, le të themi që detyrimi është individual. Njësia e burimeve njerëzore i bën të ditur çdo zyrtari/punonjësi në momentin e punësimit këto detyrime. Ndërsa në rastin tonë të organeve drejtuese, por përfshirë dhe të gjithë zyrtarët, detyrimi për zbatim, unë mendoj të vlerësojmë për të votuar propozimin e zotit Çakaj.

Kush është dakord me propozimin e zotit Çakaj për të riformuluar pikën 2 të nenit 16? Kolegë?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Votojmë në tërësi nenin 16, pra të dy pikat, pikën 1 dhe pikën 2.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Deri tani kishim në shqyrtim dhe votim pikën 1. Duke pasur parasysh të gjitha nenet.

Pika 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.23.02.2022*

Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit “Për miratimin e Kodit të Etikës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”.

Kolegë edhe njëherë, pasi kemi votuar në parim dhe nen për nen kërkoj edhe njëherë votën tuaj kolegë!

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Do të lutesha që administrata gjatë zbardhjes të kishte parasysh qoftë sugjerimet për përmirësime në vende të caktuara, qoftë dhe propozimet konkrete që u votuan.

Duke qenë se nuk kemi çështje tjetër në rendin e ditës për të shqyrtuar e deklaroj mbledhjen të mbyllur, faleminderit!

Vendimi nr. 22

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

